


Çfarë është 'Parlamenti i Hapur' ?

Trendet e fundit globale dhe rajonale vënë theksin tek nevoja për një ndërveprim më të strukturuar dhe agjendë të përbashkët **Parlament-Shoqëri Civile**, për të promovuar transparencën dhe angazhimin qytetar. Kjo qasje është konceptuar dhe promovuar në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), si iniciativë multilaterale që synon të sigurojë përkushtimin e shteteve anëtare në promovimin e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.




Mbi 80 shtete të botës janë pjesë e kësaj platforme, ndërkohë që zotimet dhe angazhimin e tyre shprehen përmes zhvillimit të planeve kombëtare të qeverisjes së hapur.



Përvojat nga vendet e rajonit flasin për krijim të grupeve të përbashkëta punuese, ku deputetë, staf parlamentar, aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë, bashkërisht zhvillojnë planet e veprimit. Parlamentet në Gjeorgji, Ukrainë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, dhe në shumë shtete të tjera kanë zhvilluar Plane të Veprimit për Parlament të Hapur me këtë qasje.

Krijimi i Planit për Parlament të Hapur në Shqipëri

Sekretariati i Kuvendit për Transparencë ka konceptuar një proces sipas të cilit krijimi i Planit të veprimit për Parlament të Hapur do të realizohet në këto faza:



Roli i NDI

NDI së bashku me partnerët e tjerë ka pasur një rol qëndror në zhvillimin e standardeve të transparencës parlamentare. Në bashkëpunim me Fondacionin Sunlight dhe Rrjetin e Shteteve të Amerikës Latine për Transparencë Legjislative NDI ka mbështetur procesin e hartimit të Deklaratës për Parlament të Hapur dhe ka zhvilluar platformën openingparliament.org, si forum për shkëmbimin e përvojave më të mira në fushën e transparencës parlamentare. Në kuadër të Partnetit për Qeverisje të Hapur (OGP), NDI ka mbështetur Parlamentet në përshirjen në planet nacionale të OGP, në krijimin e Grupeve Punuese për Transparencës Parlamentare (LOWG) si dhe në zhvillimin e Planeve për Parlament të Hapur.

Në kuadër të projektit PACEP (Mbështetja për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar), i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, NDI mbështet përpjekjet për zhvillimin e një dialogu të mirëstrukturuar midis Kuvendit dhe shoqërisë civile mbi çështjet e transparencës dhe angazhimit qytetar si dhe ofron asistencë teknike të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit.